



Ligjërata 3

Kuptimi i kostos dhe llojet e saj

vazhdim... (apo pjesa e dytë)

KONTABILITETI MENAXHERIAL

© 2014 Ylber Prekazi

Java e dytë

Rishikim i
kapitullit
të kaluar

- Kostoja – kuptimi i saj
 - Objektet e kostos
 - Saktësia e përcaktimit të kostos
- Klasifikimet e përgjithshme të kostos
 - Kosto direkte dhe indirekte
 - Kosto prodhuese dhe joprodhuese
 - Kosto e periudhës kundrejt kostove të produktit

Java e tretë

- Klasifikimi i koston sipas sjelljes
 - Kostoja fikse
 - Kostoja variabël
 - Kostoja e mikse

1-3


KOSTOT VARIABËL

- **Kostot variabël** janë ato kosto që në total ndryshojnë në përpjesëtim të drejtë me ndryshimet që pëson niveli i aktivitetit.
- Që një kosto të quhet variabël, ajo duhet të ndryshojë në lidhje me të ashtuquajturën **bazë aktiviteti**.

KOSTOT VARIABËL...

Jo të gjitha **kostot variabël** kanë të njëjtin model sjellje. Disa prej tyre sillen si *kosto të vërteta*, ndërsa disa të tjera sillen si *kosto variabël të shkallëzuara*.

Funksioni i koston variabël të shkallëzuar




1-5

KOSTOT FIKSE

- ❖ **Kostot fikse janë ato kosto që, në total, mbeten të pandryshueshme pavarësisht nga ndryshimet në nivelin e aktivitetit.**
 - Është e rëndësishme të potencohet se pak kosto janë plotësisht fikse.
 - Kur thuhet se një kosto është fikse, d.m.th. që ajo është fikse brenda një intervali përkatës të aktivitetit.

1-6

KOSTOT FIKSE...



1-7

KOSTOT MIKSE

- ❖ **Kostoja mikse (e përbërë)** është kostoja që përmban njëkohësisht edhe elementë variabël dhe fikse.

Ekuacioni linear për koston mikse është:


$$Y = a + bX$$

Y=kosto totale mikse
a=kostoja fikse totale
b=kosto variabël për njësi të aktivitetit
X=niveli i aktivitetit

1-8

KOSTOT MIKSE...

Grafiku i koston mikse



1-9

Shembull:

➤ **Një linjë e telefonis fikse në Kosovë, ka këto kosto:**

- 10 euro për posedimin e numrit (ku përfshihen 50 minuta në telefonat fikse brenda Kosovës)
- 0.08 euro/min për thirrje drejt telefonisë fikse brenda Kosovës
- 0.20 euro/min për thirrje drejt telefonisë fikse jashtë Kosove
- 0.15 euro/min për thirrje drejt operatorëve mobil lokal
- 0.30 euro/min për thirrjet drejt operatorëve mobil ndërkombëtar

➤ Gjatë muajit Shtator janë bërë këto thirrje:

- 120 min me telefoni fikse brenda Kosovës
- 30 min me telefonin fikse jashtë Kosovës
- 40 min me telefonin mobile lokale
- 20 min me telefonin mobile ndërkombëtare

➤ **Kërkesa:**

- Sa është kostoja fikse totale gjatë muajit shtator?
- Sa është kostoja fikse për njësi?
- Sa është kostoja variabile totale gjatë muajit shtator?
- Sa është kostoja totale gjatë muajit shtator?

DETYRË:(5 pikë)

➔ Duhet ta merrni vendin e punës ku punoni, ose ndonjë departament të organizatës tuaj apo produkt (shërbim) dhe t'i identifikoni se cilat janë:

- ➔ Kostot e materialit direkt,
- ➔ Kostot e punës direkte,
- ➔ Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (shërbimit),
- ➔ Kostot e periudhës,
- ➔ Kostot e produktit (shërbimit),
- ➔ Kostot fikse dhe
- ➔ Kostot variable.

➔ *Afati i dorzimit është 30 nëntor 2014.*

FUNDI I LIGJERATË SË TRETË

PYETJE???